

FOCUS ULTRA

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS07



GHS08



GHS09

“Lexo fletëudhëzuesin përpara përdorimit”

Të evitohen rreziqet e shendetit të njeriut dhe ambjentit, në përpuethshmëri me instruksionet për përdorim.

FOCUS ULTRA është herbicid selektiv sistemik që përdoret për kontrollin e barërave të këqija gjethengushta një dhe shumëvjeçare në kulturat jo graminore si rrepa, panxharsheqeri, panxhari foragjer, patate, lini, pambuku, soja, foragjeret bishtajore, perime, qepe, bimë zbukuruese, pyje, fidanishte, etj.

Lënda vepruese: *Cycloxydim 100 g/litër.*

Formulimi: *Koncentrat i emulsionueshëm (EC).*

Masat parambrojtëse:

Deklaratat e rrezikut

H227: Lëng i ndezshëm.

H319: Shkakton irritim serioz të syve.

H315: Shkakton irritim të lëkurës.

H304: Mund të jetë fatale nëse gëlltitet dhe hyn në rrugët e frymëmarrjes

H336: Mund të shkaktojë përgjumje ose marramendje.

H361: Dyshohet se shkakton dëmtim të pjellorisë ose të fëmijës së palindur.

EUH401: Te evitohen rreziqet e shendetit të njeriut dhe ambjentit, në përputhshmëri me instruksionet për përdorim.

Deklarata parandaluese (Parandalimi)

P101: Në rast helmimi tregojeni mjekut etiketën e produktit.

P102: Mbajeni në vende të sigurt, larg fëmijëve.

P103: Lexoni etiketën para përdorimit.

P280: Vishni doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/pajisje mbrojtëse për fytyrën/ pajisje mbrojtëse për sytë.

P271: Përdoreni vetëm jashtë ose në zona të ajrosura mirë.

P210: Mbajeni larg nga nxehtësia, sipërfaqet e nxehta, shkëndijat, flakët e hapura dhe burimet e tjera të ndezjes.

P261: Shmangni thithjen e pluhurit/tymit/gazeve/mjegullës/avujve/solucionit gjatë frymëmarrjes.

P201: Merrni udhëzime të veçanta para përdorimit.

P202: Mos trajto derisa të keni lexuar dhe kuptuar masat e sigurisë.

P264: Lahuni me ujë të bollshëm dhe sapun tërësisht pas trajtimit.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

Deklarata parandaluese (Reagimi)

P312: Telefononi Qendrën e helmimeve ose një mjek. Nëse nuk ndiehi mirë

P305+P351+P338: NË RAST KONTAKTI NË SY: Shpëlani vazhdimisht për disa minuta me ujë. Hiqni lentet e kontaktit, nëse janë të pranishme dhe nëse është të lehtë për t'u bërë. Vazhdoni shpëlarjen.

P301+P310: NË RAST GËLLTITJE: Telefononi menjëherë Qendrën e helmimeve ose një mjek.

P304+P340: NË RAST SE MERRET NËPËRMJET RRUGËVE TË FRYMËMARRJES: Largojeni personin në ajër të pastër dhe vendoseni në pozicion që të marrë frymë lirisht.

P302+P352: NË RAST KONTAKTI NË LËKURË : Lajeni me ujë të bollshëm.

P308 + P313: Nëse je ekspozuar dhe je i shqetësuar: Merrni këshilla/kujdes mjekësor.

P332+P313: Në rast irritimi të lëkurës: Merrni këshilla/kujdes mjekësor.

P391: Mblidhni rrjedhjet.

P331: Mos provokoni të vjella.

P337+P313: Nëse irritimi në sy vazhdon: Merrni këshilla/kujdes mjekësor.

P362+P364: Hiqni veshjet e ndotura dhe lani veshjet e ndotura para ripërdorimit.

P370+P378: Në rast zjarri: Përdorni spërkatje me ujë, pluhur të thatë, shkumë ose dioksid karboni për shuarje.

për të shuar zjarrin.

Deklarata paraprake (Ruajtja):

P403+P233: Ruajeni në një vend me ventilim të mirë. Mbajeni kontenjerin të mbyllur fort.

P405: Mbajeni të kyçur.

Deklarata parandaluese (Shkatërrimi)

P501: Shkatërroni ose largoni përmbajtjen/ambalazhin në përputhje me rregullat në fuqi.

Përdorimi:

Përdoret në kulturat: panxharsheqeri, panxhar foragjer, rrepë, patate, lin, pambuk, sojë, foragjere bishtajore, jonxhë, luledielli, shalqi, karrotë, sallatë, domate, qepë, bizele, bathe, bimë zbukuruese, pyje, fidanishte, etj.

Preparati merret nga pjesët e gjelbra të bimës dhe nga rrënjët. Kontrollon barërat e këqija gjethengushta si: gramin rreshqanor (*Agropyron repens*), barimëzat (*Agrostis spp.*), pugacen si bishtmiu (*Alopecurus myosuroides*), tërshërën e egër (*Avena spp.*), bromuset (*Bromus spp.*), gramin (*Cynodon dactylon*), melin e pergjakur (*Digitaria sanguinalis*), muharin (*Echinochloa crus-galli*), festuken (*Festuca arundinacea*), egjrat (*Lolium spp.*), etj.

Trajtimi bëhet kur shumica e barërave të këqija janë të ndjeshme, në fazat e para të zhvillimit (në stadin e 2-3 gjetheve). Në fazat e mëvonshme (mbi 6 gjethe) kontrollohen me vështiresi. Barërat e këqija gjethengushta njëvjeçare kontrollohen dhe me vonë se stadi i 2-4 gjetheve. Për kontrollin e barërave të këqija gjethengushta njëvjeçare dhe të lashtave që mund të mbijnë spontanisht, përdoret 1-2 lit preparat/ha.

Për kontrollin e barërave të këqija gjethengushta shumëvjeçare është mirë të përdoret përpara rritjes së plotë të rizomave ose me trajtime të përsëritura. Kunder gramit rreshqanor (*Agropyron repens*) përdoret kur është 10-15 cm i lartë, me 3 lit/ha ose bëhen trajtime të përsëritura në interval 4-6 javë me normat 1.5 + 1.5 lit preparat/ha.

Për gramin (*Cynodon dactylon*) trajtohet kur është 10-15 cm i lartë, me 4 lit/ha ose trajtime të përsëritura në interval 6-7 javë me normat 2 + 2 lit preparat/ha.

Për tallën (*Sorghum halepense*) nga rizomat kur është 20-40 cm e lartë, me 1.5-2 lit preparat/ha ose trajtime të përsëritura 3-4 janë larg njeri tjetrit me normat 1+1 lit preparat/ha.

Në shumicën e rasteve ne shkojmë me një dozë prej 2 lit/ha në (luledielli, sojë, patate, rrepë, panxhar sheqeri, etj)

Për të kontrolluar barërat e këqija njëvjeçare: 1 lit/ha (Për kontrollin e barërave të këqija njëvjeçare dhe bimët spontane ne përdorim 1-2 lit përgatitje për hektar), dhe për kontrollin e barërave të këqija shumëvjeçare, doza është 2 lit/ha. Dozat duhen rritur kur moti është i thatë. Trajtimet me volum të solucionit 50-200 lit/ha janë me efikase se ato me volum 300-400 lit/ha. Presioni 3 bar.

Vërejtje mbi përdorimin:

Nuk duhet të bjerë shi të paktën 1 orë pas përdorimit.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat dhe dozat e rekomanduara.

Ndikimi në mjedis:

H401: Toksik për gjallesat ujore. H411: Toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata. Nuk është toksik për bletët dhe krimbat e tokës. Është i dëmshëm për peshqit.

Karenca:

Nuk aplikohet.

Magazinimi:

Ruhet në ambalazhin origjinal në vende të thata, pa ndriçim, të freskëta dhe të ventiluara.

Nr dhe data e regjistrimit: Nr. 61/2, datë 8.01.2013;

Sasia neto e PMB-së, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1 lit.

Data e prodhimit:.....Printuar nga makineria në ambalazh..... ;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 3 vite;

Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenja të tjera identifikuese:.....Printuar nga makineria në ambalazh..;

Tipi i ambalazhit bazë: Shishe plastike COEX, HDPE;

Emri dhe adresa e Aplikantit: BASF SE. **Adresa:** Aktiengesellschaft, Ludwigshafen, Gjermani.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: BASF SE. **Adresa:** Aktiengesellschaft, Ludwigshafen, Gjermani.